

SPECIFIKIME TEKNIKE

Rikonstruktion i Shkolles 9 vjecare "Fshat"

Fshati Fshat

Njesia Vendore Gryke-Çaje

PROJEKT ZBATIM

PROJEKTUES

A-STUDIO
ARCHITECTURE and URBAN DESIGN

Ark. Andrit SHEHU



RELACION

Specifikimet e punimeve sipas

Kushteve Teknike te Zbatimit ne Ndertim

Nisur nga detyra e projektimit, nga verifikimi i gjendjes aktuale ne prani te perfaqesuesve te pushtetit lokal dhe drejtuesve te shkolles, pergatisim projektin e rikonstruksionit te saj dhe kushtet teknike me te cilat duhet te behet nderhyrja e punimeve ndertimore gjate zbatimit te punimeve te shkolles 9 vjecare Fshat, me karakteristika si me poshte:

- Viti I Ndertimit te godines: **1978**
- Numri i kteve te Godine: **3kt**
- Mbulesa : **Tarrace (panele b/a te parapregatitura)**
- Themelet : **Themele te vazhduara me murature guri**
- Muratura e katit perdhe (I): **Murature guri (muret mbajtes 60cm; muret ndares 25cm)**
- Muratura e katit pare (II): **Murature me dopio blloqe betoni**
- Muratura e katit dyte (III): **Murature me tek bllok betoni**

Rikonstruksioni i ketij objekti behet i domosdoshem si rezultat i degradimit ne tersi, ne saje te mos nderhyrjeve ne riparime, qe nga ndertimi i saje, ne vitin 1978.

Si rezultat i erozioni, mos disiplinimi i ujrave te bardha te shiut ne perimetrin e godines, ka sjelle cedime ne themelet e kafazit te shkalleve.

Sirezultat jane krijuar plasaritje dhe çarje te mureve, kryesisht ne kafazin e shkalleve dhe ne disa pjese te tjera te godines.

Ne 10 vitet e fundit godina shkollore eshte goditur nga termetet te cilet kane perkeqesuar edhe me tej situaten duke thelluar dhe zmadhuar çarjet e murit, kryesisht ne kafazin e shkalleve.

Shkak tjeter kryesore ne perkeqesimin e gjendjes se godines ka qene degradimi dhe demtimi total i shtresave h/izoluese te ttraces, ku si rezultat, ne objekt ka patur prezences te vazhdueshme te lageshtise ne te gjitha ambientet e katit te trete, dhe pjeserisht ne ato te katit te dyte, duke i degraduar, dhe kthyer te papershtatshme dhe jashte kushteve normale per zhvillimin e procesit mesimor, kryesisht ambientet e katit te trete.

Si shkak i demtimeve te shtresave h/izoluese te tarraces, amortizimit dhe degradimit te muratures mbajtese te katit te trete, çarjeve te muratures se kafazit te shkalleve nga kati I trete deri ne nivelin e katit te pare, kane sjelle rrezikshmeri dhe pasiguri per jeten e nxenesve dhe trupes mesimore qe zhvillojne veprimtari ne kete objekt.

Ndaj si rezultat nuk garantohet qendrueshmeria, kryesisht e paneleve b/a te parapregatitura, pjese e soletes dhe mbuleses se kafazit te shkalleve dhe klasave.



Si pasoje e demtimeve dhe problematikave te evidentuara ne objekt, te nevojës per hapsira mesim dhenie, si dhe numrit te nxenesve, arrijme ne konkluzionin e eliminimit te katit te trete, duke e kthyer kodinen nga 3kt ne 2 kt, mendim ky i konsultuar me te gjithë aktoret institucional pergjegjes.

Godina ne tersi ka degradime dhe demtime te suvave (ne ambientet e brendshme dhe te jashtme), shtresave te dyshemese me pllaka, instalimet elektrike jane totalisht te degraduara dhe jofunksionale, mungojne ambientet e nyjeve sanitare, dyert, dritaret dhe e gjithë baza mobiliare e shkolles eshte e degraduar dhe jashte funksioni, godina nuk ka kanalizime, drenazhime, apo sistemime oborri, gjithashtu demtime ka dhe rrethimi i oborrit te shkolles, ku nje pjese e rrethimit mungon, si dhe ka nevojë per shtim dhe plotesim te rrethimit ne tersi.

Te gjitha nderhyrjet qe do t'i behen objektit te shkolles jane paraqitur ne fletet perkatese te projektit, bashke me shenimet teknike.

Menyra e nderhyrjes ne punimet e rikonstruksionit do te realizohet si me poshte :

➤ FAZA I

Klasat ku do te kryhen punimet do te jene te boshatisura nga nxenesit dhe mjetet shkollore, per arsye te rrezikshmerise qe paraqet nderhyrja ne kete objekt.

Do te realizohen ;

1. Rrethimi i shkolles per te penguar hyrjen e banoreve qe jetojne prane saj si dhe te nxenesve qe zhvillojne mesim.
2. Hapja e punimeve ne pjese per te mos lejuar zberthime te muratures dhe te paneleve te katit te dyte
3. Eliminimin e goditjeve te muratures se objektit dhe te soletes se nderkatit per arsye te mos demtimit para meremetimit.
4. Fotografimin e te gjithë procesit te punimeve..
5. Paisjen me çertifikate te materialeve per cdo proces para fillimit te punimeve .
6. Proven e kampionit te betonit per marken e betonit te perdorur.
7. Masat e sigurimit teknik dhe firmosjen e proces –verbalit para fillimit te punimeve .
8. Kontrollin e objektit para fillimit te punimeve çdo dite per te eliminuar çdo te papritur.
9. Te gjitha punimet e rikonstruksionit do te ndiqen nga inxhinjeri i objektit i cili do te firmose proces-verbalet e punimeve te maskuara sipas fazes se punimeve.

➤ FAZA II

- Do te behet hapja e kanalit te drenazhimit ne pjesen perimetrale te shkolles 96 ml, duke disiplinuar te gjitha ujrat nentoksor dhe siperfaqesor me tuba drenazhimi dhe mbledhur ne nje pike per largimin e tyre, duke zbatuar parametrat dhe dimensioned e kanalit, kjo sipas projektit. Punimet do te kryhen ne kohe te thate, pa lageshti dhe reshje.

- Do te realizohet muri mbajtes ne pjesen pasme 23 ml dhe perparme te shkolles 23 ml, sipas projektit, per realizimin e dy funksioneve, ate mbajtes dhe qellimin e sistemimit te oborrit ne dy pjeset e shkolles.
- Do te realizohet trotuari perimetral i godines me gjersi 100cm dhe trashesi betonit 10cm, i derdhur ne vend, pasi te sistemohet dhe te ngjishet toka ne perimetrin nga ku jane bere dhe germimet e drenazhimit dhe mureve mbajtes.
- Do te realizohet nivelimi i siperfaqes perpara shkolles me shtrese zhavori, duke e kthyer ne nje siperfaqe horizontale nga muri deri tek fundi i oborrit te shkolles. Materiali qe do te perdoret per nivelim do te ngjeshet me vibrues deri ne vendosjen e ekuilibrit natyror. Shtresa niveluese me zhavor nuk duhet te jete me e vogel se 30-35 cm trashesi.

Zbatimi i ketyre punimeve eshte i detyrueshem per te mos lejuar ujrat e shiut dhe ato siperfaqesore te demtojne konstruksionin e godines shkollore.

➤ FAZA III

- Do te behet prishja dhe eleminimi i katit te trete deri ne nivelin e dyshemes, çmontimi dhe prishja e muratures se katit, ve zbritja me vinç (makineri pune ne lartesi) e paneleve te parapregatitura prej betoni te armuar dhe e materialeve te muratures, sipas kushteve te sigurise dhe kujdesit ne pune duke i depozituar diku ne ambientete oborrit te shkolles, e me pas transportimin e tyre ne vendedepozitimin me te afert te mbetjeve te ngurta.
- Do te behet prishja pjesore e muratures se gurit te kafazit te shkalleve, ne pjeset e demtuara per te bere nderhyrje ne riparimin dhe perforcimin deri ne nivelin final qe do te jete soleta e katit te dyte, nen çati (sipas shenimeve perkatese ne projekt).

Mbi zbatimin e kesaj faze dhe kryrjen e punimev, shkolla dhe perimetri i oborrit te shkolles (kantieri i ndertimit) do te jete i boshatisur nga nxenesit, per arsye te rrezikshmerise qe paraqet nderhyrja ne kete faze.

➤ FAZA IV

- Do te behet realizimi i kornizave anesore prej betoni te armuar ne perimetrin e soletes ekzistuese te katit te dyte, per nxjerrjen e strehes b/a 35cm dhe realizimin e mbuleses me çati, ku ne soleten ekzistuese do behen thyerje per nxjerrjen e hekurave te cilet do te saldohen dhe lidhen sipas skemes ne prerjekt, detaji a-a.
- Do te behet plotesimi I soletes mbi kafazin e shkalleve me elemente b/a te parapregatitura, do te lidhet dhe perforcohet me pjesen e vjeter ekzistuese me brez b/a, zgare hekuri dhe do te nivelohet nga siper me shtrese betony me soleten e vjeter.



- Do te behet ndertimi dhe ngritja e çatise sipas hollesive dhe planeve ne projekt.

➤ FAZA V

- Pasi kryhen punimet e mesiperme fillojne punimet per meremetimin e suvase se brendeshme dhe te jashtme sipas fletes perkatese te projektit.
- Te gjitha klasat do te shtrohen me pllaka dhe plintuse.
- Pllakat e katin te pare dhe te dyte do te hiqen per te realizuar kuoten si ne project.
- Pllakat ne katin e dyte do te hiqen detyrimisht per te mos shkaktuar rritjen e ngarkeses se soletes se nderkatit.
- Ne rast se shtresa mbushese nen pllaka eshte me rere ajo do te hiqet dhe do te shtrohet shtresa niveluese.
- Nen pllaka do te vendoset shtrese niveluese dhe pllakat do te vendosen me kolle.
- Preventivi i punimeve per rikonstruksionin e shkollës eshte hartuar ne baze te volumeve te parashikuara ne projekt dhe te çmimeve te zberthyer per çdo ze punimesh qe do te kryhet.
- Pas punimeve te ndertimit do te realizohet rikonstruksioni i rrjetit elektrik ekzistues sipas fleteve dhe hollesive te projektit.
- Keto punime do te realizohen njeheresh me punimet e meremetimit te suvase.
- Çmimi i çdo zeri pune perfshin vleren e materialit qe do te perdoret, pagesat e fuqise puntore, transportin e materialeve, sigurimet shoqerore te puntoreve, normen e fitimit te firmes se ndertimit .
- Banjot e shkollës do te vishen me pllaka majolike.
- Dyert e kateve do te vendosen ne permasat sipas projektit.
- Pragjet e dritareve jane parashikuar me mermer i cili do te realizohet me dhembin ne anen e jashtem per te kulluar ujrat dhe do jene ne dy pjese.
- Suvatimi i jashtem do te realizohet me granil me gervishtje dhe pas kesaj do te vendosen ulluqet horizontale dhe vertikale si ne projekt.
- Standartet e përdorura në këtë ‘Specifikim Teknik’, jane mbeshtetur jo vetëm në vizatimet por dhe në manualët ligjore dhe libra te tjere keshillues
- Gjate kryerjes se punimeve prishese, kontraktuesi duhet te marre masa qe te mbroje jeten e nxenesve dhe komunitetit ne ate zone ku kryhen keto punime prishese.
- Per kete, duhen evituar mbingarkesat nga te gjitha anet e strukturave nga grumbuj dhe materiale.
- Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshte, duhet patur kujdes qe te parandalohet shperndarja ose renia e materialeve ose te projektohet ne menyre te tille qe mos te perbeje rrezik per njerezit.
- Kur perdoren mekanizmat per prishje si: vinç, ekskavatore hidraulik dhe thyes shkembinjsh te behet kujdes, qe nje pjese te tyre te mos kene kontakt me kablllo elektrik.



- Kontraktori duhet te ngreje rrjete te pershtatshme, bamera mbrojtese, ne menyre qe te parandaloje aksidentime te personave nga materialet qe bien, si dhe te mbaje nen kontroll territorin, ku do te kryhen punimet.
- Ne rastin e punimeve te shkolles duhet te largoje te gjitha nxenesit dhe punimet duhet te kryhen kur klasat te jene te boshatisura nga nxenesit dhe mjetet mesimore.
- Çdo skeleri e kerkuar duhet skicuar ne pershtatje me KTZ dhe STAZH.
- Nje skelator kompetent dhe me ekspence, duhet te marre persiper ngritjen e skelerive qe duhet te çdo tipi.
- Kontraktori duhet te siguroje, qe te gjitha rregullimet e nevojshme, qe i jane kerkuar skelatorit te sigurojne stabilitetin gjate kryerjes se punes. Kujdes duhet treguar qe ngarkesa e copave te mbledhura mbi nje skeleri, te mos kaloje ngarkesen per te cilen ato jane projektuar.
- Duhet marre te gjitha masat e nevojshme qe te parandalohet renia e materialeve nga platforma e skeles.
- Skeloret duhen te jene gjate kohes se perdorimit te pershtatshme per qellimin per te cilin do perdoren dhe duhet te jene konform te gjitha kushteve teknike.
- Duhet te merren masa qe te behet nje rrethim i objektit, si dhe veshja e te gjitha skelerise me rrjete mbrojtese per te eliminuar renien e materialeve dhe duke perfshire shenjat sinjalizuese sipas kushteve te sigurimit teknik. Skeleri çeliku te tipit kembalec, konform KTZ dhe STAZH, duke perfshire ndihmen per transport, mirembajtje, montim, ankorim, çmontime etj.

PROJEKTUES

A-STUDIO ARCHITECTURE and URBAN DESIGN

Ark. Andrit SHEHU

